



KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

NPL EKO THERANDA SH.A.

Nr. 52-2025

Data 01.09.2025



NPL "EKO-THERANDA"
SH.A. SUHAREKË

BORDI I DREJTORËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE NË SUHAREKË

Në mbështetje të nenit 21, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-31/2008", si dhe nenit 9 dhe 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-13/2012, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-009, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2015" e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3, të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale, "Eko-Theranda" në Suharekë, 01-Nr-110-43153, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Theranda në Suharekë, shpall këtë:

KONKURS

Për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale, "Eko-Theranda" në Suharekë

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale, "Eko-Theranda" në Suharekë

Paga: Sipas Rregullores së brendshëm në harmoni me politika e NPL-së

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur Kryeshef Ekzekutiv i ndërmarrjes publike lokale, "Eko-Theranda" në Suharekë, duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, dhe neni 9 dhe 13, të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-009, si vijon:

- Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara:
 - në administrim të biznesit;
 - financa korporative;
 - financa;
 - menaxhim të thesarit;
 - banka;
 - konsulencë në biznes;
 - industri ose
 - të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.
 - Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

KUSHTET:

Një person ka të drejtë të shërbejë si Kryeshef Ekzekutiv i ndërmarrjes publike lokale, "Eko-Theranda" rreth Suharekës, nëse:

- Nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Nuk ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike Lokale ku kandidati aplikon.

Detyrat dhe Përgjegjësit e Kryeshefit Ekzekutiv

1. Kryeshefi Ekzekutiv (KE) do të ketë autoritetin e lidhjes së kontratave në emër të NPL-së, marrjes së vendimeve, aprovimit të rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhrave si dhe të përfaqësojë NPL-në në pajtim me Statutin dhe aktet ligjore duke i nënshkruar ato, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve.
2. Aktivitetet e biznesit, detyrat dhe menaxhmenti i NPL-së do të bëhet në pajtim me udhëzimet, mbikëqyrjen dhe përgjegjësitë e KE-së, në pajtim me Statutin dhe aktet ligjore të kompanisë dhe vendimet e Bordit të drejtorëve po ashtu.
3. Të gjitha çështjet lidhur me biznesin e NPL-së që nuk janë përgjegjësi e Mbledhjes së përgjithshme, Bordit të drejtorëve, komisionit të auditimit ose zyrtarit të auditimit të brendshëm, do të vendosen nga apo në pajtueshmëri me udhëzimet dhe përgjegjësitë e KE-së.
4. KE do të ketë të drejtën t'i propozojë bordit punësimin apo largimin e këtyre zyrtarëve të kompanisë:
 - a). Zyrtarit kryesor i financave dhe
 - b). Sekretarit e NPL-së.
 - c). Cilin do arëtarë tjetër që Bordi ka të drejtë ta punësojë apo largojë do të jetë vetëm e drejtë e Bordit të drejtorëve.
 - d). Sipas Ligjit, KE ka të drejtë të punësojë ose largojë nga puna stafin e NPL-së dhe të delegojë këtë të drejtë zyrtarëve tjerë.
5. KE po ashtu mund të bëjë punët në vijim:
 - a) Të këshillojë dhe ndihmojë Bordin e drejtorëve në përcaktimin e politikave të NPL-së dhe planet e saja strategjike afatgjata;
 - b) T'i propozojë Bordit të drejtorëve kandidatët e përshtatshëm për punësim siç janë ZKF dhe sekretarët duke caktuar së paku 2 kandidatë potencial për secilin konkurs/ pozitë;
 - c) T'i shpërndajë në bazë të përgjegjësi të veta Bordit të drejtorëve draft dokumentet që janë përgjegjësi e Bordit për aprovim.
 - d) T'i paraqesë Bordit të drejtorëve sa herë që është e mundur ose së paku një herë në tre muaj raportin e transaksioneve kryesore të bëra nga NPL-ja dhe vendimet kryesore të ndërmarra lidhur me menaxhimin e biznesit dhe aktivitetet e kompanisë.
 - e) T'i dorëzojë sipas përgjegjësi të veta Bordit të drejtorëve dokumente, letra dhe njoftime lidhur me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e takimit të tij;
 - f) T'i propozojë Bordit të drejtorëve indikatorët adekuat për matjen e performancës së NPL-së dhe t'i ofrojë Bordit në baza të rregullta së paku çdo tre muaj raporte mbi matjen e performancës së NPL-së ndaj këtyre indikatorëve;

- g) Të krijojë dhe shqyrtojë organogramin e NPL-së dhe shpërndajë njoftim mbi hierarkinë e vendim-marrjes në NPL-së si dhe zinxhirin komandues ndërmjet menaxherëve dhe punëtorëve të NPL-së;
- h) Ta sigurojë komisionin e auditimit me të gjitha informacionet e nevojshme dhe ndihmën e nevojshme po ashtu;
- i) Ta sigurojë zyrtarin për auditim të brendshëm me të gjitha informatat dhe ndihmën e kërkuar nga ky i fundit; dhe
- j) Të merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjeve Publike Lokale duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim, me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike Lokale në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohen në Zyrën Nr. 1 (zyra e pritës) në Administratën e Komunës në Suharekë me seli në Rr. "Br. 123".

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 029/ 272/ 662.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale do të bëhet në bazë të nenit 22 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 12 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-009

Inkurajohen të gjithë të interesuarit nga popullata jo-shumicë dhe të interesuarit që do të përfaqësojnë interesat e Komunës ku NP vepron, që të aplikojnë në konkursin për Kryeshef Ekzekutiv të Ndërmarrjeve Publike Lokale.

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në uebfaqen zyrtare (prej datës 01 shtator 2025 deri më datën 30 shtator 2025).

Kryesuesi i Bordit të Drejtues

Korab MUQA

